

Albanian Financial Institution sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Së bashku me raportin e Audituesit të Pavarur

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	1
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e Pozicionit Financiar	3
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse	4
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	5
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare	6
Shënime mbi pasqyrat financiare	7– 28

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe ortakët e Shoqërisë Albanian Financial Institution sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albanian Financial Institution sh.p.k** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimin dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësimë të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



18 maj 2018

Teit Gjini
Auditues Ligjor



Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Pasqyra e pozicionit financiar
më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	5	2,383,104	1,209,201
Aktive afatgjatë jomateriale	6	1,917,779	1,185,431
Totali i aktiveve afatgjatë		4,300,883	2,394,632
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	7	21,919,052	44,800,836
Hua për klientët (neto)	8	443,758,999	124,790,405
Llogar të arketueshme nga tatimet	9	71,238,309	972,844
Parpagime dhe shpenzime të shtyra	10	75,861	54,350
Totali i aktiveve afatshkurtra		536,992,221	170,618,435
Totali i aktiveve		541,293,104	173,013,067
KAPITALI			
Kapitali themeltar		101,240,000	101,240,000
Humbje të mbartura		(2,446,938)	(25,721)
Fitimi(Humbja) i ushtrimit		(12,628,831)	(2,421,217)
Totali i kapitalit	11	86,164,231	98,793,062
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	12	147,912,129	-
Totali i detyrimeve afatgjatë		147,912,129	-
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurter	13	46,728,903	67,896,684
Llogari të pagueshme	14	17,552	4,951,087
Te ardhura të shtyra	15	-	272,905
Detyrime tatimore	16	717,625	218,224
Detyrime të tjera	17	330,850	881,105
Detyrime ndaj paleve të lidhura	18	259,421,814	-
Totali i detyrimeve		455,128,873	74,220,005
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		541,293,104	173,013,067

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shenime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	19	19,070,147	1,701,873
Shpenzime për interesa	20	(1,309,039)	(281,684)
Të ardhura neto nga interesat		17,761,108	1,420,189
Shpenzime për provizione	21	(4,262,426)	(1,260,509)
Shpenzime për paga	22	(17,291,076)	(1,560,745)
Shpenzime zhvlersimi dhe amortizimi	23	(338,192)	(9,893)
Shpenzime nga veprimtari të tjera operative	24	(6,794,528)	(1,070,616)
Total shpenzime		(28,686,222)	(3,901,763)
Humbje nga kurset e këmbimit	25	(1,692,392)	60,357
Të ardhura/(Shpenzime) të tjera financiare (neto)	26	(11,325)	
Fitimi/humbja para tatimit		(12,628,831)	(2,421,217)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	27	-	
Fitimi/humbja e vitit		(12,628,831)	(2,421,217)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(12,628,831)	(2,421,217)

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Financial Institution sh.p.k

(Vlerat janë në Lekë)


**Pasqyra e ndryshimeve në kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali i nënshkruar	Humbje të akumuluar	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2016	20,000,000	-	(25,721)	19,974,279
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:			(2,421,217)	(2,421,217)
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	81,240,000			81,240,000
Transferim në fitime të mbartura		(25,721)	25,721	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	101,240,000	(25,721)	(2,421,217)	98,793,062
				-
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:			(12,628,831)	(12,628,831)
Emetimi i kapitalit të nënshkruar				-
Transferim në fitime të mbartura		(2,421,217)	2,421,217	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	101,240,000	(2,446,938)	(12,628,831)	86,164,231

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe nënshkruar nga menaxhimi më 27/03/2018 dhe do t'i paraqiten për miratim Asamblesë së Ortakëve:


Znj. Arta Gurabardhi
Administrator


Znj. Entela Gjyzari
Hartuese e Pasqyrave Financiare

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(12,628,831)	(2,421,217)
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	338,192	9,893
Fitim nga shitja e mjeteve	(159)	
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Rënie/(rritje) në hua te dhena	(318,968,594)	(124,790,405)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(70,265,465)	(972,844)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	254,164,520	6,297,600
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(21,511)	(54,350)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	(147,381,848)	(121,931,323)
 Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(2,336,264)	(2,404,525)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	91,980	
Investime të tjera afatgjata		20,000,000
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(2,244,284)	17,595,475
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	147,912,129	67,896,684
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër	(21,167,781)	
Emetimi i kapitalit të nënshkruar		81,240,000
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	126,744,348	149,136,684
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(22,881,784)	44,800,836
Mjetet monetare në fillim të periudhës	44,800,836	-
Mjetet monetare në fund të periudhës	21,919,052	44,800,836

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Albanian Financial Institution sh.p.k (më poshtë "Shoqëria") është një shoqëri e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 27.11.2015 dhe është pajisur me NIPT L52327028M.

Objekti i Shoqërisë është ushtrimi i aktivitetit të faktoringut si dhe aktiviteve të tjera financiare jo-bankare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria ofron të gjitha format e kredisë, faktoringun, qira financiare, ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve, shërbime këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e shoqërisë.

Shoqëria është licensuar në bazë të ligjit nr 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe rregullores "Për Licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jo-banka", miratuar me vendim nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me liçencë nr 07/1.

Kapitali aksionar i Shoqërisë është 101.240.000 lekë dhe zotërohet nga aksionerët:

- Besnik Leskaj i cili zotëron 60% të aksioneve;
- Redjan Basha i cili zotëron 20% të aksioneve;
- Arta Gurabardhi e cila zotëron 20% të aksioneve.

Administrator i Shoqërisë është Znj. Arta Gurabardhi.

Selia e Shoqërisë është Rruga "Themistokli Gërmenji", Pallati përballë RTSH-së, Kati I, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë.

Nr i punonjësve në 31 dhjetor 2017 ka qenë 10 punonjës (31 dhjetor 2016: 8 punonjës).

2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 janar 2017 ose pas kësaj date:

- Përmirësimet vjetore të SNRF (Cikli 2014 - 2016): SNRF 12 Shpalosjen e interesave në njësi të tjera
- SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat (Amendim – Njohja e taksës së shtyrë si asset për humbje të porealizuara)
- SNK 7 Pasqyra e Flukseve Monetare (Shpalosjen e Amendimeve fillestare)
-

Nuk ka patur standarde apo interpretime të reja, të cilat kanë hyrë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2017 ose pas kësaj date, që të kenë efekt të qenësishëm në pasqyrat financiare të kompanisë. *Ndryshimet në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"- Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - e miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2016 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017).*

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF) (VAZHDIM)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël të cilat behën efektive në periudhat e ardhshme kontabël dhe që kompania nuk ka vendosur ti përvetësojë më shpejt. Më të rëndësishmet janë:

- SNRF 9 Blerësit e instrumentave financiar (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date)
- SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me blerësit (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date); dhe
- SNRF 16 Qiratë (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2019 ose pas kësaj date)
- Të tjera

Kompania nuk parashikon standard të tjerë të publikuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël, që nuk janë në përdorim, të kenë ndikim material në pasqyrat financiare.

- KIRFN 22 Përkthimin e Monedhave të huaja dhe Vlerësimin në Avancë (në fuqi më 1 janar 2018)
- Amendime të klasifikimeve të SNRF 2 dhe Matja e Transaksioneve me Pagesë Aksionesh (në fuqi më 1 janar 2018)
- Amendime të SNRF 4: Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiar me IFRS 4 Kontratat e Sigurimit (në fuqi më 1 janar 2018)
- Amendime të SNA 40: Transfertat e Pasurive Investuese (në fuqi më 1 janar 2018)
- Përmirësime vjetore të Standardeve SNRF, cikli 2014 – 2016, që ndeshet me çështjet e SNRF 1 për herë të parë
- Adoptimi dhe SNA 28 Investime në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (në fuqi më 1 janar 2018)
- KIRFN 23 Paqartësi mbi Pozicionin e Taksës mbi të Ardhurat (hyn në fuqi më 1 janar 2019)
- Amendime të SNRF 9 Karakteristikat e Parapagimeve me Kompensim Negativ (hyn në fuqi më 1 janar 2019)
- Amendime të SNA 28: Interesat Afatgjatë në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (hyn në fuqi më 1 janar 2019)
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (hyn në fuqi më 1 janar 2021)

3. BAZAT E PËRGATITJES

3.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

3.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

3.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të pa parashikuar.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

3. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

3.1 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.2.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Shoqëria rishikon portofolet e saj të qirave financiare, hua dhe paradhënie faktoring dhe hua të tjera në baza mujore për të vlerësuar zhvlerësimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, shoqëria bën gjykime për të parë nëse ka ndonjë të dhënë të vrojtueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të pritshme nga një portofol huaje para se rënia të mund të identifikohet me një hua dhe paradhënie individuale në këtë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e vrojtueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësit, ose kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e qirasë financiare ose huamarrjes faktoring nga huamarrësit.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të cilat janë matur me kosto të amortizuar llogariten në bazë të diferencës së shumës së mbartur të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të fluksit të përlllogaritur të mjeteve monetare të skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen tek pasqyra e të ardhurave dhe paraqiten në llogarinë e fondit të huave dhe paradhënieve. Kur një ngjarje e mëvonshme influencon në zvogëlimin e shumës së humbjes nga zhvlerësimi i aktivitetit, humbja kthehet tek pasqyra e të ardhurave. Fluksi i parashikuar i mjeteve monetare nga huatë dhe paradhëniet paraqiten me vlerën e skontuar të kolateralit. Të ardhurat nga kolaterali vlerësohen pas zbritjeve nga vlera e tregut dhe përcaktimit të planit kohor të rikuperimit, në varësi të llojit të kolateralit.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari për fondin e huave dhe paradhënieve si dhe të investimeve në letra me vlerë të vendosjes, nëse ka. Nëse njohja e një ngjarje që ka ndodhur pas zhvlerësimit zvogëlon humbjen nga zhvlerësimi, zvogëlimi i humbjes nga zhvlerësimi rimerret përmes pasqyrës së të ardhurave.

3.2.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e këmbimeve në monedhë të huaj regjistrohen me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në ditën e transaksionit. Aktivitet dhe pasivitet monetare të emetuara në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhë funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën e bilancit. Zërat jo monetarë të mbajtur me vlerë të drejtë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike nuk konvertohen. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 ishin si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
EUR/LEK	132.95	135.23
USD/LEK	111.10	128.17

4.2 Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Interesi efektiv në rastin e instrumenteve të Shoqërisë ndryshon nga ai nominal vetëm për komisionin e disbursimit që aplikohet vetëm në momentin fillestar të dhënies së qirave financiare. Të ardhurat e interesit llogariten fillimisht me normën nominale të interesit ndërsa komisioni i disbursimit, që është pjesë e normës efektive të interesit, njihet progresivisht si e ardhur në mënyrë lineare përgjatë afatit të financimit. Në këtë mënyrë, metoda e njohjes së të ardhurave nga interesi nuk ndryshon në mënyrë materiale nga metoda e interesit efektiv.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat që paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë:

- Interesat për aktivin dhe detyrimin financiar të cilat maten me koston e amortizuar llogariten me anë të metodës së normës efektive të interesit; dhe
- Interesat për letrat me vlerë të vendosjes të cilat llogariten me anë të metodës së normës efektive të interesit.

4.3 Pagesat e qirasë

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Shoqëria si një qiramarrës

Qiratë që nuk transferojnë tek shoqëria në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operacionale. Pagesat e qirasë operacionale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.3 Pagesat e qirasë

Shoqëria si një qiradhënës (qira financiare)

Qiratë ku shoqëria transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivit klasifikohen si investim neto në qira financiare. Fillimi i qirasë është data e disbursimit të fondeve. Në këtë datë:

- një qira klasifikohet si qira financiare dhe;
- përcaktohen shumat që do të njihen me fillimin e afatit të qirasë.

Fillimi i qirasë është data në të cilën qiramarrësi ka të drejtë të përdorë aktivin e blerë me qira financiare. Kjo është data e njohjes fillestare të qirasë (p.sh. njohja e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve që rezultojnë nga investimi neto në qira financiare, sipas rastit). Në pasqyrën e pozicionit financiar, Shoqëria paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare neto. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të pafituara. Të ardhurat nga investimi neto në qira financiare të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënës në fillim të afatit të qirasë financiare janë vlera e drejtë e aktivit, ose nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut. Shoqëria vlerëson krijimin e fondeve rezervë për zhvlerësimin e investimit neto në qira financiare, duke përdorur politikat e përdorura për zhvlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura me koston e amortizueshme (p.sh. qiratë financiare, llogaritë e arkëtueshme), duke qënë se kredite dhe investimi neto në qira financiare kanë karakteristika të ngjashme rreziku.

4.4 Hua dhe paradhënie, faktoring

Kontratat Faktoring, të cilat rregullohen në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 9630, datë 30.10.2006, "Për Faktoringun", përmbajnë 3 palë: Faktorin, Furnizuesin dhe Debitorin, të përshkruara shprehimisht në këtë ligj.

Shoqëria si një faktor

Hua-të dhe paradhënie faktoring përfaqësohen nga dy nënprodukte financiare të ofruara nga Shoqëria, për të cilat kjo e fundit përfaqëson në të dyja rastet faktorin.

- Faktoring-u i drejtpërdrejtë me garanci – përfaqëson financimin e faturave të shitjes. Në këtë marrëdhënie kontraktuale, faktori financon faturat e lëshuara nga furnizuesi kundrejtë debitorit. Furnizuesi luan rolin e klientit për faktorin dhe mbetet debitor për pagesën e kostove të detyrimit. Gjithashtu, në rast mos-shlyerje të vlerës së principalit nga ana e debitorit, furnizuesi mbetet debitor/ garant edhe për shumën e principalit të financuar nga faktori, e cila e ben këtë formë faktoring-u "me garanci".
- Faktoring-u i anasjelltë me garanci – përfaqëson financimin e faturave të blerjes. Në këtë marrëdhënie kontraktuale, faktori financon faturat e lëshuara nga furnizuesi kundrejtë debitorit. Debitori luan rolin e klientit për faktorin dhe mbetet debitor për pagesën e kostove të detyrimit. Në këtë formë faktoring-u, furnizuesi bëhet pjesë e kontratës së faktoring-ut me qëllim transferimin e të drejtave të faturave të financuara, nga furnizuesi tek faktori. Debitori mbetet përgjegjës për rikthimin e vlerës së faturave të financuara në perfundim të afatit të kontratës faktoring.

Shoqëria përllogarit dhe bën të pagueshëm një interes fiks nominal mbi balancën mujore të papaguar që përbëhet nga shuma e faturave të financuara. Ripagesa e principalit bëhet e kërkueshme në perfundim të afatit të kontratës faktoring.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.5 Huatë dhe paradhëniet të tjera për klientët

Huatë dhe paradhëniet për klientët janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe institucioni nuk ka për qëllim t'i shesë në periudha afatshkurtra. Huatë dhe paradhëniet klasifikohen si hua dhe të arkëtueshme.

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive. Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar ose, kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

4.6 Instrumenta financiare

Të gjithë aktivet dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

a. Matja fillestare e instrumentave financiarë

Shoqëria fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet e dhëna klienteve, depozitat, huatë e marra në datën kur ato janë krijuar.

Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën shoqëria bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit të aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve apo detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare.

Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

b. Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivitetet financiare klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuar:

- Mjetet monetare dhe ekuivalentë
- Hua dhe paradhënie për faktoring
- Investimi neto në qira financiare

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe ç'rregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brënda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

c. Investime në qira financiare dhe faktoring

Hua dhe paradhënie për klientët (përfshirë qiratë financiare dhe faktoring) përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, dhe që shoqëria nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që shoqëria ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që shoqëria gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që shoqëria, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.6 Instrumenta financiarë (vazhdim)

d. Investime në qira financiare dhe faktoring

Pas matjes fillestare me vlerën e drejtë, shumat e huave dhe paradhëniet për klientët janë matur më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit nominal. Kostot e transaksionit janë kosto rritëse të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen, shitjen ose nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivitetit apo detyrimit financiar. Të ardhurat apo shpenzimet e interesit të përfshira në fitim ose humbje përfshijnë interesin nga aktivet ose detyrimet financiare me kosto të amortizueshme me një normë interesi nominal.

e. Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të shoqërisë.

f. Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e instrumentit financiar përcaktohet si çmimi që do të përfitohet nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e mundur, shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, shoqëria kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Shoqëria nuk ka instrumenta financiarë të matur me vlerën e drejtë.

Për qëllime dhënieje të informacioneve shpjeguese në lidhje me vlerën e drejtë, shoqëria ka përdorur modele vlerësimi aty ku ka të dhëna të observueshme tregu; nëse këto të dhëna nuk janë të disponueshme, atëherë shoqëria ka përdorur gjykimin e saj në përcaktimin e vlerave të drejta të instrumentave financiarë.

Shoqëria e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e inputeve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuar për instrumenta të ngjashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat mes instrumentave.

g. Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to

Aktivitetet monetare dhe ekuivalentët me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivitetet monetare dhe ekuivalentët me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.7 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktivitetit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijinë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.8 Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:: është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiviteti do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kosto e aktivitetit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivitetit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.8 Aktivet Afatgjata Jomateriale (vazhdim)

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

Aktivët jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

4.9 Fondet për pensione

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit, sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Autoritetet Fiskale është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim përfitimi të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

4.10 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatuësishëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohëshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

4.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë dhe Manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.12 Angazhimet dhe kontigjencat

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.13 Garancitë financiare dhe angazhimet e huave

Garancitë financiare janë kontrata të cilat i lejojnë Institucionit të kryej pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin në rast humbjeje, kur një debitor nuk arrin të shlyejë huanë në përputhje me kushtet e instrumentit të borxhit. Angazhimet e huasë janë angazhime të cilat ofrojnë kredi me kushte dhe terma të paracaktuar. Detyrimet që rrjedhin nga garancitë financiare apo angazhime për të siguruar një hua me normë interesi më të ulët se niveli i tregut maten me vlerën e drejtë dhe vlera e drejtë amortizohet përgjatë jetës së garancisë apo angazhimit. Detyrimi vlerësohet me vlerën më të lartë midis vlerës së amortizuar dhe vlerës aktuale të çdo pagese që pritet të shlyhet në bazë të kontratës.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

5. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë

	Mobilje e pajisje zyre	Pajisje informatike	Ne proces	Totali
Me kosto				
Gjendja më 1 janar 2016	-	-	-	-
Shtesa	730,983	-	488,111	1,219,094
Transferime	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	730,983	-	488,111	1,219,094
Shtesa	1,271,675	332,241	-	1,603,916
Pakësime	(100,915)	-	-	(100,915)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,901,743	332,241	488,111	2,722,095
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2016	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	9,893	-	-	9,893
Kthim amortizimi	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	9,893	-	-	9,893
Amortizimi i vitit	289,740	48,452	-	338,192
Pakësime	(9,094)	-	-	(9,094)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	290,539	48,452	-	338,991
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2016	721,090	-	488,111	1,209,201
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,611,204	283,789	488,111	2,383,104

6. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Lëvizjet e aktiveve afatgjata jomateriale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	AAJM ne proces	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2016	-	-
Shtesa	1,185,431	1,185,431
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,185,431	1,185,431
Shtesa	732,348	732,348
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,917,779	1,917,779
Amortizimi i akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2016	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	-
Gjendja neto më 31 dhjetor 2016	1,185,431	1,185,431
Gjendja neto më 31 dhjetor 2017	1,917,779	1,917,779

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

7. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTET E SAJ

Balanca e mjeteve monetare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare EUR	21,023,861	44,201,224
Mjete monetare LEK	895,191	599,612
	<u>21,919,052</u>	<u>44,800,836</u>

8. HUA PËR KLIENTËT

Huatë për klientët më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Hua për Leasing	373,056,209	4,759,826
Hua për Faktoring	74,000,000	121,291,089
Klient për aktivitetin NPL (kredi të keqija)	5,154,085	
Klientë të tjere	1,402,705	-
Huadhënie afatshkurtër	1,196,550	-
Interesa të perlogaritura	958,996	
Vlera bruto	455,768,545	126,050,915
Zbritje nga zhvlerësimi	(5,522,936)	(1,260,510)
Vlera neto e huase	450,245,609	124,790,405
Komisione administrimi të papërfituara	(6,486,610)	
	<u>443,758,999</u>	<u>124,790,405</u>

Lëvizjet në fondin rezervë për mbulimin e humbjeve

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Gjendja më 1 janar	1,260,510	
Rimarrje për vitin	(1,217,561)	
Zhvlerësimi për vitin	5,479,987	1,260,510
Gjendja më 31 dhjetor	<u>5,522,936</u>	<u>1,260,510</u>

9. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA TATIMET

Balanca e llogarive të arkëtueshme nga tatimet më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
TVSH për tu rimbursuar	71,208,309	942,844
Tatimi mbi fitimin	30,000	30,000
	<u>71,238,309</u>	<u>972,844</u>

10. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Balancat e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Komisione per kredi		36,000
Tollona karburanti	56,071	
Parapagime	19,790	18,350
	<u>75,861</u>	<u>54,350</u>

11. KAPITALI THEMELTAR

Kapitali i Shoqërisë është 101.240.000 lekë, përbëhet nga 3 kuota dhe zotërohet nga aksionerët:

- Besnik Leskaj i cili zotëron 60% të aksioneve;
- Redjan Basha i cili zotëron 20% të aksioneve;
- Arta Gurabardhi e cila zotëron 20% të aksioneve.

Fitim/(Humbjet) e mbartura për vitin 2017 janë në vlerën (2,446,938) lekë.

12. HUA AFATGJATË

Në këtë zë përfshihen huaja afatgjatë balanca e të cilës më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Hua afatgjatë Intesa San Paolo	148,592,711	-
Komisione administrimi te huase	(680,582)	
	<u>147,912,129</u>	<u>-</u>

13. HUA AFATSHKURTRA

Në këtë zë përfshihen huaja e marrë nga ortaku balanca e të cilës më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Huamarrje afatshkurtër Intesa San Paolo	46,728,903	-
Huamarrje afatshkurtër nga ortaku	-	67,896,684
	<u>46,728,903</u>	<u>67,896,684</u>

14. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë EUR	-	4,238,108
Furnitorë LEK	-	712,979
Furnitorë për fatura të pambërritura	17,552	-
	<u>17,552</u>	<u>4,951,087</u>

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

15. TË ARDHURA TË SHTYRA

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura të periudhave të ardhshme	-	272,905
	<u>-</u>	<u>272,905</u>

16. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	300,827	139,397
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	416,798	73,275
Tatimi në burim	-	5,552
	<u>717,625</u>	<u>218,224</u>

17. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime ndaj personelit	21,360	502,311
Detyrime ndaj palëve të lidhura	290,348	245,348
Kreditorë të tjerë	19,142	133,446
	<u>330,850</u>	<u>881,105</u>

18. DETYRIME NDAJ PALËVE TË LIDHURA

Detyrimet ndaj palëve të lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Derdhje ndaj ortakëve	259,421,814	-
	<u>259,421,814</u>	<u>-</u>

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

19. TË ARDHURA NGA INTERESAT

Të ardhurat nga interesat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga interesa faktoringu	1,729,796	1,678,243
Komsione nga faktoringu	216,739	
Komisione administrimi qira financiare	794,712	23,630
Të ardhura nga qira financiare	14,040,810	-
Të ardhura nga interesa kredie	155,144	-
Të ardhura nga kredia NPL	675,598	-
Komisione sherbimi	1,289,148	
Te ardhura nga penalitete	168,200	-
	<u>19,070,147</u>	<u>1,701,873</u>

20. SHPENZIME PËR INTERESA

Shpenzimet për interesa për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për interesa	1,309,039	281,684
	<u>1,309,039</u>	<u>281,684</u>

21. SHPENZIME PËR PROVIZIONE

Shpenzimet për provizione për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Provizione - Kontrata Faktoring	740,000	1,212,910
Rimarrje provigjoni faktoring	(1,212,910)	-
Provizione Kredia NPL	1,030,817	-
Provizione - Kontrata Leasing	3,697,187	47,599
Rimarrje provizioni leasing	(4,651)	-
Provsione kredi te tjera	11,983	
	<u>4,262,426</u>	<u>1,260,509</u>

22. SHPENZIME PËR PAGA

Shpenzimet për paga për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	15,679,071	1,421,584
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,612,005	139,161
	<u>17,291,076</u>	<u>1,560,745</u>

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

23. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime amortizimi të aktiveve afatgjata	338,192	9,893
	<u>338,192</u>	<u>9,893</u>

24. SHPENZIME NGA VEPRIMTARITË E TJERA OPERATIVE

Shpenzimet nga veprimtarite e tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime qira	2,245,227	344,322
Shërbime ligjore dhe noteriale	345,034	456,984
Shërbime nga palë të treta	1,338,322	-
Mirëmbajtje dhe riparime	66,711	28,018
Shpenzime per karburant	144,429	
Shpenzime komisioni	721,511	-
Shpenzime marketingu	111,546	-
Shpenzime per faqen web	200,690	
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	105,149	-
Kancelari	369,418	40,140
Shpenzime telekomunikacioni	350,461	41,000
Shpenzime për shërbimet bankare	177,583	60,496
Shpenzime të tjera	545,980	32,448
Taksa dhe tarifa vendore	67,000	67,000
Gjoba dhe dëmshpërblime	5,467	208
	<u>6,794,528</u>	<u>1,070,616</u>

25. FITIM/(HUMBJA) NGA KURSET E KËMBIMIT

Fitim/(Humbja) nga kurset e këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura /(Shpenzime) nga kembimet valutore	(1,692,392)	60,357
	<u>(1,692,392)</u>	<u>60,357</u>

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

26. SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE (NETO)

Shpenzimet e tjera financiare (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Te ardhura nga interesat	123,016	-
Shpenzime komisioni	(134,341)	-
	<u>(11,325)</u>	<u>-</u>

27. SHPENZIMI AKTUAL I TATIMIT MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	(12,628,831)	(2,421,217)
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	325,792	2,018
<i>Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</i>	(12,303,039)	(2,419,199)
Humbje fiskale e mbartur	(2,444,919)	(25,720)
Fitim (humbja) Tatimore	(14,747,958)	(2,444,919)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	-	-
	<u>(12,628,831)</u>	<u>(2,421,217)</u>

28. PALËT E LIDHURA

Balancat me palët e lidhura të përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar dhe volumin e transaksioneve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>		<u>31 dhjetor 2016</u>	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Abkons shpk	2,736,043			671,798
Arian Leskaj				135,230
Arta Gurabardhi		123,444,075		67,896,684
Besnik Leskaj		102,887,080		
Redi Basha		33,090,659		
ARC shpk	23,797,124			
	<u>26,533,167</u>	<u>259,421,814</u>	<u>-</u>	<u>68,703,712</u>

	<u>31 dhjetor 2017</u>		<u>31 dhjetor 2016</u>	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Abkons shpk	690,088	1,394,142		897,535
Arian Leskaj		542,200		135,230
ARC shpk	10,131,120	273,632		-
	<u>690,088.00</u>	<u>2,209,974</u>	<u>-</u>	<u>1,032,765</u>

29. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Përdorimi i instrumentave financiare e ekspozon Institucionin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i tregut
- rreziku i normës së interesit
- rreziku i kreditit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i monedhës

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikëqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiarë të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kredite dhe depozitat. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të administrojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Ndryshimet në normën e interesit ndikojnë:

- Përfitimim nga ndryshimi i të ardhurës neto nga interesi dhe niveli i të ardhurave apo shpenzimeve të tjera që ndikohen nga interesi;
- Vlerën ekonomike të aktiveve të Institucionit, detyrimeve dhe gjendjes jashtë bilancit, sepse vlera aktuale e flukseve të ardhshme monetare (dhe në disa raste edhe vetë flukset monetare) ndryshon kur ndryshojnë normat e interesit.

Instrumentat financiarë me interes fiks dhe variabël për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor	
	2017	2016
Instrumenta me interes fiks	74,000,000	58,154,231
Aktive Financiare	74,000,000	126,050,915
Detyrime Financiare	-	(67,896,684)
Instrumenta me interes variabël	178,931,145	-
Aktive Financiare	374,252,759	-
Detyrime Financiare	(195,321,614)	-
	178,931,145	58,154,231

28. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**Risku i kreditit**

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për institucionin nëse klienti apo pala tjetër nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikësëpari prej llogarive të arkëtueshme nga Moneygram) dhe prej aktiviteteve të saj financiar, që përfshijnë kreditë dhe paradhëniet për klientët, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiarë.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Institucioni konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit (si rreziku që vjen nga vet klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori.

Administrimi i rrezikut arrihet me:

- Formulimin e politikave të kreditimit, me kërkesat për mbulimin me kolateral, vlerësimin e kredive, vlerësimin dhe raportimin e rrezikut dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.
- Themelimin dhe monitorimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e kredive. Bordi Drejtues i delegon autoritetin e tij për aprovimin e limiteve Komitetit të Kreditimit.
- Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kreditit. Drejtimi i Institucionit vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, para aprovimit përfundimtar të disbursimit.
- Rinovimet dhe rishikimet e kredive janë subjekt i politikës së kredive në fuqi.
- Kufizimi i përqëndrimit të ekspozimit të kundërpalëve. Institucioni strukturon nivelet e rrezikut të kreditimit që ndërmerr duke vendosur limite mbi shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës ose një grup huamarrësish.
- Mbikëqyrja e ekspozimit aktual ndaj limiteve në mënyrë të shpeshtë. Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditit administrohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit për të përballuar shlyerjen e principalit dhe interesit, madje edhe duke i ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Ekspozimi maksimal i shoqërisë më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare(paperfshire paratë në dorë)	21,919,052	44,800,754
Hua dhe paradhënie(Factoring)	74,000,000	121,291,089
Investime në qera financiare neto	374,346,122	4,759,826
TVSH e arkëtueshme	71,208,309	942,926
Tatim fitim i arkëtueshëm	30,000	30,000
Klientë për aktivitetin NPL	5,154,085	
Huadhënie afatshkurtër	2,155,546	
Aktive të tjera	112,792	
Totali	<u>548,925,906</u>	<u>171,824,595</u>
Angazhime të kreditimit të padisbursuara	-	-
Totali angazhimeve të lidhura me kreditë	-	-
Risku kreditit	<u>548,925,906</u>	<u>171,824,595</u>

29. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Risku i kreditit (vazhdim)

Risku I kreditit sipas sektoreve financiare paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016		
	Faktoring	Qira financiare	Hua te tjera	Faktoring	Qira financiare	Hua te tjera
Bujqësia,gjuetia, silvikultura						
Industria nxjerrëse		39,752,858				
Industria përpunuese		10,284,294			4,759,826	
Ndertim		58,312,931				
Hotele dhe restorante		11,062,360				
Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni		1,880,070		121,291,086		
Tregtia, riparimi I automjeteve dhe artikujve shtëpiake	74,000,000	92,299,849	1,196,550			
Arsimi						
Shëndeti dhe veprimtaritë sociale		11,436,813				
Shërbime kolektive, sociale dhe individuale		132,716,021	5,154,085			
Te tjera		15,311,013				
	74,000,000	373,056,209	6,350,635	121,291,086	4,759,826	-

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

28. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**Risku i Likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristikë likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do t'i duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Tabela e mëposhtme paraqet aktivet dhe detyrimet sipas maturitetit më 31 dhjetor 2017, bazuar në flukset hyrëse/dalëse të të parasë të institucionit duke reflektuar cdo supozim ripagëse të hershme ose mbajtje:

Përshkrimi	31 dhjetor 2017				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Hua të dhëna	75,402,705	1,198,345	379,167,495	-	455,768,545
Llogari të arkëtueshme të tjera	1,729,796				1,729,796
Mjete monetare në arkë dhe bankë	21,919,052				21,919,052
Totali	99,051,553	1,198,345	379,167,495	-	479,417,393
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(1,066,027)				(1,066,027)
Hua		(46,728,903)	(408,014,525)		(454,743,428)
Totali	(1,066,027)	(46,728,903)	(408,014,525)	-	(455,809,455)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2017	97,985,526	(45,530,558)	(28,847,030)	-	23,607,938

Përshkrimi	31 dhjetor 2016				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Hua të dhëna	121,662,355	417,961	3,970,599		126,050,915
Llogari të arkëtueshme të tjera	972,844			-	972,844
Mjete monetare në arkë dhe bankë	44,800,836	-	-	-	44,800,836
Totali	167,436,035	417,961	3,970,599	-	171,824,595
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(67,896,684)	-	-	-	(67,896,684)
Hua	(6,050,416)	-	-	-	(6,050,416)
Totali	(73,947,100)	-	-	-	(73,947,100)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2016	93,488,935	417,961	3,970,599	-	97,877,495

28. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**Risku i monedhës**

Institucioni është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës përmes transaksioneve në monedhë të huaj. Meqë monedha e përdorur nga Institucioni në paraqitjen e pasqyrave financiare është Lek, pasqyrat financiare të Institucioni ndikohen nga luhatjet në kurset e këmbimit midis Lek-ut dhe monedhave të tjera.

Institucioni është i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përmes pozicioneve të hapura valutore. Pozicioni i hapur valutore neto në një monedhë të caktuar është shuma, ekuivalente në Lek e diferencës ndërmjet totalit të aktiveve dhe totalit të detyrimeve të Institucionit në atë monedhë.

Institucioni është i detyruar të respektojë limitet e Pozicionit të Hapur Neto Forex dhe të Pozicionit të Hapur Total Neto Forex të vendosura nga Banka e Shqipërisë.

Analiza e pozicionit monetar më 31 dhjetor 2017 sipas monedhave në të cilat paraqiten është si më poshtë:

Përshkrimi	31 dhjetor 2017			
	EUR	ALL	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	374,799,896	152,206,959		527,006,855
Mjete monetare në arkë dhe bankë	21,023,861	895,191		21,919,052
Totali	395,823,757	153,102,150	-	548,925,907
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera		(1,066,028)		(1,066,028)
Hua	(454,743,428)			(454,743,428)
Totali	(454,743,428)	(1,066,028)	-	(455,809,456)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2017	(58,919,669)	152,036,122	-	93,116,451

Përshkrimi	31 dhjetor 2016			
	EUR	ALL	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	4,759,826	122,263,933	-	127,023,759
Mjete monetare në arkë dhe bankë	44,201,224	599,612	-	44,800,836
Totali	48,961,050	122,863,545	-	171,824,595
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(4,346,242)	(1,704,174)		(6,050,416)
Hua	(67,896,684)	-	-	(67,896,684)
Totali	(72,242,926)	(1,704,174)	-	(73,947,100)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2016	(23,281,876)	121,159,371	-	97,877,495

30. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Angazhimet per qera operative paraqiten me poshte:

	<u>Viti 2017</u>	<u>Viti 2016</u>
Per t'u paguar deri ne 1 vit	1,994,250	795,152
Per t'u paguar deri ne 5 vjet	830,938	
	<u><u>2,825,188</u></u>	<u><u>795,152</u></u>

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

31. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT FINACIAR

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.